



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2021

VENDIM

Nr. 356, datë 09.09.2021

PËR

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {...} DHE VIJIMIN E PROCEDURËS
SË NGRITJES NË DETYRË NË GJYKATËN ADMINISTRATIVE TË APELIT,
PËR POZICIONIN E LIRË TË SHPALLUR ME VENDIMIN NR. 290,
DATË 06.07.2021, TË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në shkronjën “a” të pikës 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në nenin 8, në pikën 4, të nenit 47, në pikat 7 dhe 8, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në shkronjën “ç”, pika 12, Seksioni Ç, Kreu VI, të Vendimit të tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, pasi shqyrtoi materialet e çështjes dhe relacionin e përgatitur nga relatori, z. Ilir Toska,

VENDOSI:

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...} dhe vijimin e procedurës së ngritjes në detyrë në Gjykatën Administrative të Apelit, për pozicionin e lirë të shpallur me Vendimin nr. 290, datë 06.07.2021, të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqjen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR